



**ZYRA E PROKURIMIT**

Nr. 03/2021

Nr. Protokolli: 03/2021

<b>Për:</b>	<b>N.T.SH . " NODE TECH ", Rr. Xhavit Sylaj, 23000, Suhareke , Grup i Operatorëve Ekonomik: N.P.SH. "AFA-ING"; "K-ING" SH.P.K.</b>
<b>Kopje:</b>	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
<b>Nga:</b>	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
<b>Lënda:</b>	<b>VENDIM</b>
<b>Datë:</b>	<b>12.01.2020</b>

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a ) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës 31.12.2020 & 02.01.2021, të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: " N.T.SH . " NODE TECH ", Rr. Xhavit Sylaj, 23000, Suhareke & Grup i Operatorëve Ekonomik: N.P.SH. "AFA-ING"; "K-ING" SH.P.K., Suharek, 23000, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me paisje teknologjike(Komjuterë ,komplet,fotokopje ,kamera të sigurisë ,printerë,videoprojektore dhe paisje tjera" me Nr. të Prokurimit: 624-20-5060-1-2-1&624-020-097-121 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- 1. Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim të datave: 31.12.2020 & 02.01.2020 të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: N.T.SH . " NODE TECH ", Rr. Xhavit Sylaj, 23000, Suhareke & Grup i Operatorëve Ekonomik: N.P.SH. "AFA-ING"; "K-ING" SH.P.K., Suharek, 23000, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me paisje teknologjike(Komjuterë ,komplet,fotokopje ,kamera të sigurisë ,printerë,videoprojektore dhe paisje tjera" me Nr. të Prokurimit: 624-20-5060-1-2-1&624-020-097-121, kundër Njoftimit për Vendimin e AK –së, të datës 28.12.2020 të publikuar në platformën elektronike.
- 2. Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 28.12.2020 .
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## Arsyetim

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 31.12.2020 & 02.01.2021, ka pranuar kërkesa për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit **Furnizimi me paisje teknologjike (Komputera ,komplet,fotokopje ,kamera te sigurise ,printera,videoprojektore dhe paisje tjera**” me Nr. të Prokurimi: **624-20-5060-1-2-1&624-020-097-121,** kundër Njoftim per Vendimin e AK –së, të datës 28.12.2020 të publikuar në platformen elektronike.

Për **N.T.SH . " NODE TECH "**, Rr. Xhavit Sylaj, 23000, Suhareke : Ak- Suharekë ju sqaron se në oferten tuaj të dorëzuar në platformen elektronike e-prokurimi, **ING i Elektornikes nuk permbush kerkesen e AK-se sipas kërkesë në Dosje të Tenderit me qka është vertetut edhe vendimit të OSHP-se te dates 15.12.2020 me numer te protokolit 917-931/20.**

Për **Grup i Operatorëve Ekonomik: N.P.SH. "AFA-ING"; "K-ING" SH.P.K.,** Suharek, 23000 Ak- Suharekë ju sqaron se në oferten tuaj të dorëzuar në platformen elektronike e-prokurimi, nuk keni ofuar dëshmi **ISO Standard për Projektin në fjalë, pir ISO Standardi i ofruar nuk ploteson kerkeset per kete project. Ju keni ofru Iso Standard** për projekte te natyres tjeter si: ( keni ofru per ndertimin e kanalizimeve, mirmbajte etj) Poashtu **nuk i'u jeni pergjegjë kerkeses per sqarime shes të kërkuar nga AK te dates 18.12.2020, ISO Standardi i ofruar nuk ploteson kerkeset per kete projekt** Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

